

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË AKSIONARE ME OFERTË PRIVATE
“O-SP Albania” SHA**

Aksionari themelues:

- **ARMANDO METALIAJ**, i biri i Deli-ut, i datëlindjes 26.05.1984, lindur në Bajram Curri dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I40526044K

bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar); ligjin nr. 9879, datë 21.02.2008 “ Për titujt” dhe ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), sot më datë 23.02.2021, harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

**NENI 1
Emri dhe Forma**

Emri i shoqërisë është “**O-SP Albania**”. Shoqëria ka formën e një shoqërie aksionare me ofertë private. Në të gjitha aktet dhe dokumentet që dalin nga shoqëria, emërtimi i saj do të ndiqet nga inicialet “SHA”. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

**NENI 2
Zyra Qendrore**

Zyra qëndrore e shoqërisë tregtare “**O-SP Albania**” SHA është në adresën Fshati Muçaj, Vorë, me Nr.Pasurie 321/29, Zona Kadastrale 2726.

**NENI 3
Objekti i Veprimtarisë**

Shoqëria tregtare “**O-SP Albania**” SHA ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Import, eksport, shitje dhe tregtim me shumicë dhe pakicë, transport dhe magazinimi i gjithë produkteve të naftës dhe nënprodukteve të saj, gazit dhe produkteve energjetike.
- Import, transport, tregtim dhe magazinimi i vajrave lubrifikantë.
- Shitje pjesëve të këmbimit, gomave, riparim makinash. Riparim dhe mirëmbajtje e pjesëve mekanike dhe të mortorrit. Riparim dhe mirëmbajtje karrocerie. Riparim dhe mirëmbajtje impjanti elektrik. Riparim dhe mirëmbajtje e gomave. Mbledhje, depozitim, shkatërrimi i mjeteve rrugore ose i pjeseve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura.



NENI 4
Kohëzgjatja

Shoqëria tregtare “O-SP Albania” SHA do të ushtroje veprimtarinë e saj për një afat kohor të pacaktuar.

NENI 5
Kapitali i Shoqërisë

5.1 Kapitali i Shoqërisë aksionare me ofertë private “O-SP Albania” SHA është 3,500,000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë, i përbërë nga kapital në para. Ky kapital ndahet në 350 aksione, me vlerë nominale 10.000 (dhjetë mijë) lekë secila.

5.2 Aksionari ka kontribuar në kapitalin e shoqërisë si më poshtë vijon:

- Z.Armando Metaliaj ka nënshkruar 3,500,000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë dhe ka shlyer $\frac{1}{4}$ e kësaj vlere të përbërë nga kontributi në para, sipas vërtetimit të lëshuar nga Banka Kombëtare Tregtare, bashkëngjitur këtij Statuti.

5.3 Në bazë të kontributeve të derdhura aksionari Z. Armando Metaliaj, është zotëruar i 350 aksioneve të cilat përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 6
Aksionet

Aksionet e shoqërisë janë aksione të zakonshme. Çdo aksion është i barasvlershëm me një votë dhe i jep çdo aksionari të drejtën e votës në raport proporcional me pjesën e kapitalit që përfaqëson aksioni.

NENI 7
Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare “O-SP Albania” SHA mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 8
Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Këshilli Mbikëqyrës
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.



NENI 9
Administratori

Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë. Ai emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Ai emërohet në detyrë për një periudhë 3 vjeçare.

NENI 10

Statuti i shoqërisë do të përbajë rregulla të hollësishme mbi organizimin dhe funksionimin e shoqërisë, si dhe përbërjen e organeve të para drejtuese e ekzekutive të saj.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti,midis aksionarëve, të punësuarve dhe personave të tretë, si dhe çdo mosmarrëveshje tjetër që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre mund të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor ku shoqëria ka zyrën qendrore.

Ky Akt Themelimi hartohet dhe firmoset në 4 (katër) origjinale, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

AKSIONARI I VETËM

ARMANDO METALIAJ



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Armando Metaliaj". Below the signature is a stylized, handwritten mark or signature.